



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna, nenet 14 dhe 15 parag. 2.3 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, si dhe në pajtim me nenin 35 shkronja o), dhe 37 pika 4 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011 dhe Planin e punës për transparencë në Komunën e Podujevës për vitin 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, mori,

### **VENDIM**

**PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË PROPOZIM RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

Vihet në diskutim publik propozim Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës

#### **Neni 2**

Diskutimi publik zgjat 30 ditë përkatësisht prej 03 gusht 2018 deri më 03 shtator 2018 dhe debati me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më 23 gusht 2018, në orën 10:00 në objektin e Komunës, salla e Kuvendit.

#### **Neni 3**

Propozimet, sugjerimet, apo vërejtjet eventuale paraqiten ditën e mbajtjes të debatit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për marrëdhënie me publikun dhe informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, ndërsa në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresat: [nazmi.elezi@rks-gov.net](mailto:nazmi.elezi@rks-gov.net) dhe [bujar.gimolli@rks-gov.net](mailto:bujar.gimolli@rks-gov.net)

#### **Neni 4**

Propozim Rregullorja dhe materiali përkatës publikohet në ueb faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve>

#### **Neni 5**

Diskutimin publik e zbaton Drejtorja e Administratës në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtoritë tjera, koordinatorin për bashkëpunim me fshatra dhe lagje të qytetit, dhe zyrën për marrëdhënie me publikun dhe informim, që obligohen të përgatitin informatën për zbatimin e diskutimit publik dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimit ose mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

#### **Neni 6**

Vendimi hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës

**Nr. 01-020/08-0060972/18**  
**Podujevë, 31 korrik 2018**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KUVENDI I KOMUNËS**

### **PROPOZIM**

#### **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

Podujevë,  
korrik 2018

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja c) dhe nenit 34 paragrafi 34.4 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimit Administrativ të MAPL nr. 2008/08, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenet 14, 15 parag. 2.3 dhe nenit 29 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, miratoi,

## **PROPOZIM**

### **RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

##### **Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake, të përcaktuara me ligjin për vetëqeverisjen lokale.

#### **Neni 2**

##### **Fushëveprimi**

Kjo rregullore parashiheh mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të organeve të komunës, dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

#### **Neni 3**

##### **Numri i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës**

1. Në funksion të ushimit të kompetencave dhe përgjegjësive ligjore, Komuna do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane si dhe kryetarët e këshillave lokale.
2. Numri i këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane do të paraqiten në listë të veqantë, në shtojcë, që është pjesë përbërse e kësaj rregulloreje.
3. Në pamundësi që në çdo fshat, vendbanim dhe lagje urbane të zgjedhen këshillat lokale, atëherë një këshill lokal mund të përfshijë një e më shumë fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

**Neni 4**  
**Formimi i komisioneve nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale**

1. Kuvendi i Komunës formon një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë 5 anëtarë: dy anëtarë nga Kuvendi i Komunës, një anëtar nga ekzekutivi, një nga shoqëria civile dhe një nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Në aspektin teknik, administrative dhe profesional, komisioni bashkëpunon me nëpunësin civil - koordinatorin për bashkëpunim me fshatra dhe lagje urbane. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjedhet nga anëtarët e komisionit.
2. Komisioni është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve të qytetarëve, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
3. Komisioni dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.
4. Komisioni përmes Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokale, përmes:
  - 4.1.shpalljeve publike të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet ku do të zgjedhen këshillat lokale;
  - 4.2.mediave lokale;
  - 4.3.ueb – faqes zyrtare të komunës
  - 4.4.rnjeteve sociale
5. Njoftimi i publikut domosdo duhet të përmbajë: rendin e ditës, datën, kohën, vendin e mbajtjes së tubimit.
6. Mandati i komisionit pushon pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokale dhe kryetarëve të këshillave lokale.

**Neni 5**  
**Formimi i këshillave lokale dhe kriteret e përzgjedhjes**

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të ketë prej 5 deri në 7 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
2. Përbërja e këshillave lokale të fshatit duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30%. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane, jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal.
3. Tubimin e udhëheq një përfaqësues i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane i zgjedhur nga shumica e pjesëmarrësve në tubimin zgjedhor.
4. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal, në tubimin e qytetarëve, që mbledh të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
5. Zgjedhja bëhet përmes votimit të hapur apo votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve. Votimi i fshehtë mund të propozohet nga çdo qytetar që merr pjesë në takim nëse përkrahet nga shumica e pjesëmarrësve që marrin pjesë në tubim.
6. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes përkatëse urbane, mbi moshën 18 vjeqare.

7. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokale dhe kryetarët e këshillave lokale duhet të jenë qytetarë të përhershëm në atë lokalitet si dhe nuk mund të kandidohen në emër të ndonjë partie politike .
8. Kandidatët për anëtarë të këshillit lokal apo kryetarë të këshillit lokal, nuk mund të zgjedhen nëse janë janë të zgjedhur apo emëruar në poste politike.
9. Për anëtarë të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjedhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë prezent në tubimin zgjedhor.
10. Kryetari i këshillit lokal zgjedhet në mes të anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim. Nëse në rrethin e parë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e votave atëherë organizohet rrethi dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet kryetar të këshillit lokal.
11. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjedhen me mandat 4 vjeçar.
12. Së paku tre anëtarë të komisionit të komunës duhet të jenë prezent në secilin tubim zgjedhor që organizohet për zgjedhjen e këshillave lokale.

#### **Neni 6**

##### **Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale**

1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë që anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushë obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë të votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.
2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një petition për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky petition duhet të mbledh nënshkrimet e më shume se gjysma e numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Komuna duhet të lajmërohet paraprakisht për një mbledhje të tillë.
3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave në paragrafin 2, një votim i ri duhet menjëherë të bëhet në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje në mënyrë që të zgjedhet një këshill i ri lokal. Rezultatet e votimit duhet të raportohen në bazë të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
4. Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:
  - 4.1 me kryerje të mandatit;
  - 4.2 nëse vdes;
  - 4.3 nëse jep dorëheqje;
  - 4.4 nëse ndërron vendbanim;
  - 4.5 nëse shkarkohet.

#### **Neni 7**

##### **Procesverbali nga tubimi zgjedhor**

1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përshkruajë; numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.

2. Procesverbalin e nënshkruan kryesuesi i tubimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve, për zgjedhjen e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
3. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve, kryetarit të këshillit lokal duhet të bëhen publike menjëherë pas tubimit zgjedhor.

### **Neni 8**

#### **Konsultimet ndërmjet komunës dhe këshillave lokal**

1. Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim strategjik që organizohen nga komuna përkatësisht Kuvendi i Komunës apo Kryetari.
2. Varësisht nevojave, së paku një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.
3. Kryetari i Komunës duhet që së paku të organizojë dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokale. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj.
4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

### **Neni 9**

#### **Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokale**

1. Me kërkesën e këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokale të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të transferohen duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të komunës.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal.
3. Në rast të bartjes së aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna ofron mbështetje dhe burime të mjaftueshme për fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartur.

### **Neni 10**

#### **Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokale**

1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit, në të gjitha sferat në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe Drejtoritë e Komunës.
3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane duhet të informojë komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunal mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokale.
4. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
5. Këshilli lokal mund të ndërmarë aktivitetet të cilat në veqanti ndikojnë në:

- 5.1. zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
- 5.2. planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
- 5.3. mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
- 5.4. ndihmon në rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
- 5.5. siguron te dhënat elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
- 5.6. mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
- 5.7. zhvillimin e turizmit;
- 5.8. organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
- 5.9. bashkëpunimin me organet e komunës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;
- 5.10. organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin;
- 5.11. zbaton aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave në nenin 8 të kësaj rregulloreje.
6. Këshillat lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.
7. Këshillat lokale mund t'i parashtrojnë organeve dhe Drejtorive të Komunës, pyetje me shkrim për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, ndërsa përgjigjet jepen brenda afatit prej 30 ditësh.

#### **Neni 11**

##### **Roli i kryetarëve të këshillave lokale**

1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet Komunale.
2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Poashtu, ai i nënshkruan dokumentet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditëve, nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë te Kryetari i Komunës.

#### **Neni 12**

##### **Financimi i aktiviteteve**

1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokale mund të bëhet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga komuna, nga financimi i përbashkët si dhe nga donatorët, në pajtueshmëri të plotë me Statutin, Rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.
2. Këshilli lokal bën raporte gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të inkasuara, si dhe atyre të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti si dhe para organeve komunale.

#### **Neni 13**

##### **Kompenzimi i këshillave lokale**

Kompenzimi i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë.

#### **Neni 14**

#### **Mospërbushja e përgjegjëse**

Për të gjitha aktivitetet e bartura në këshillin lokal nga Kuvendi i Komunës, këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse mban obligime dhe përgjegjësi ligjore.

#### **Neni 15**

#### **Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare**

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për vetëqeverisjen lokale dhe Statutin e Komunës mbizotrojnë dispozitat e ligjit dhe Statutit.

#### **Neni 16**

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njejtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

#### **Neni 17**

#### **Hyrja në fuqi**

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas diskutimit publik respektivisht miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës, shqyrtimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës dhe publikimit në ueb-faqen e Komunës.
2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, komuna është e obliguar që brenda afatit gjashtë mujor të filloj me zbatimin e kësaj rregulloreje.

**Nr.01-016/01-0060963/18**  
**Podujevë,**  
**31 korrik 2018**





**Shtojca: 1****LISTA E KËSHILLAVE TË QENDRËS URBANE, FSHATRAVE, VENDBANIMEVE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS**

<b>KËSHILLI I QENDRËS URBANE NË QYTET</b>	
	<p>Qendra Urbane në Podujevë përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Këshilli i I-r Lokal, i cili përfshinë pjesën e qytetit - Zona 1</li> <li>-Këshilli i II-të Lokal, i cili përfshinë pjesën e qytetit - Zona 2</li> <li>-Këshilli i III-të Lokal, i cili përfshinë pjesën e qytetit - Zona 3</li> </ul> <p><i>Përkufizimi i zonave do të bëhet gjatë periudhës së diskutimit publik</i></p>
<b>Nr.</b>	<b>KËSHILLAT E FSHATRAVE – VENDBANIMEVE</b>
1.	<b>Këshilli i fshatit Bajçinë</b>
2.	<b>Këshilli i fshatit Balloc</b>
3.	<b>Këshilli i fshatit Barainë</b>
4.	<b>Këshilli i fshatit Batllavë</b>
5.	<b>Këshilli i fshatit Bellopojë</b>
6.	<b>Këshilli i fshatit Bllatë</b>
7.	<b>Këshilli i fshatit Bradash</b>
8.	<b>Këshilli i fshatit Brainë</b>
9.	<b>Këshilli i fshatit Brecë</b>
10.	<b>Këshilli i fshatit Bërvenik</b>
11.	<b>Këshilli i fshatit Buricë</b>
12.	<b>Këshilli i fshatit Dobërdol</b>
13.	<b>Këshilli i fshatit Dobratin</b>
14.	<b>Këshilli i fshatit Dumnicë e Poshtme</b>
15.	<b>Këshilli i fshatit Llapashticë e Poshtme</b>
16.	<b>Këshilli i fshatit Pakashticë e Poshtme</b>
17.	<b>Këshilli i fshatit Lupç i Poshtëm</b>
18.	<b>Këshilli i fshatit Siboc i Poshtëm</b>
19.	<b>Këshilli i fshatit Dumosh</b>
20.	<b>Këshilli i fshatit Dyz</b>
21.	<b>Këshilli i fshatit Dvorishtë</b>
22.	<b>Këshilli i fshatit Gllamnik</b>
23.	<b>Këshilli i fshatit Godishnjak</b>
24.	<b>Këshilli i fshatit Dumnicë e Epërme</b>
25.	<b>Këshilli i fshatit Llapashticë e Epërme</b>
26.	<b>Këshilli i fshatit Pakashticë e Epërme</b>
27.	<b>Këshilli i fshatit Lupç i Epërm</b>
28.	<b>Këshilli i fshatit Siboc i Epërm</b>
29.	<b>Këshilli i fshatit Gërdoc</b>
30.	<b>Këshilli i fshatit Halabak</b>
31.	<b>Këshilli i fshatit Herticë</b>
32.	<b>Këshilli i fshatit Kaçybeg</b>

33.	Këshilli i fshatit	Kalaticë
34.	Këshilli i fshatit	Sallabajë
35.	Këshilli i fshatit	Konushec
36.	Këshilli i fshatit	Kërpimeh
37.	Këshilli i fshatit	Kushevicë
38.	Këshilli i fshatit	Lladoc
39.	Këshilli i fshatit	Llaushë
40.	Këshilli i fshatit	Letanc
41.	Këshilli i fshatit	Livadicë
42.	Këshilli i fshatit	Llugë
43.	Këshilli i fshatit	Lluzhan
44.	Këshilli i fshatit	Majac
45.	Këshilli i fshatit	Muhazob
46.	Këshilli i fshatit	Metergoc
47.	Këshilli i fshatit	Merdar
48.	Këshilli i fshatit	Metehi
49.	Këshilli i fshatit	Miroc
50.	Këshilli i fshatit	Murgull
51.	Këshilli i fshatit	Obrançë
52.	Këshilli i fshatit	Orllan
53.	Këshilli i fshatit	Pollatë
54.	Këshilli i fshatit	Penuh
55.	Këshilli i fshatit	Peran
56.	Këshilli i fshatit	Popovë
57.	Këshilli i fshatit	Potok
58.	Këshilli i fshatit	Përpellac
59.	Këshilli i fshatit	Radujevë
60.	Këshilli i fshatit	Rakinicë
61.	Këshilli i fshatit	Reçicë
62.	Këshilli i fshatit	Repë
63.	Këshilli i fshatit	Revuç
64.	Këshilli i fshatit	Shajkoc
65.	Këshilli i fshatit	Shakovicë
66.	Këshilli i fshatit	Sylevicë
67.	Këshilli i fshatit	Sllatinë
68.	Këshilli i fshatit	Shtedim
69.	Këshilli i fshatit	Surdull
70.	Këshilli i fshatit	Surkish
71.	Këshilli i fshatit	Sfeçël
72.	Këshilli i fshatit	Tërrnavë
73.	Këshilli i fshatit	Tërrnavicë
74.	Këshilli i fshatit	Turuçicë
75.	Këshilli i fshatit	Velikarekë
76.	Këshilli i fshatit	Zakut
77.	Këshilli i fshatit	Zhiti

Vendbanim Urban është Qyteti i Podujevës